

Raport Narrativ Vjetor 2020

1. Progresi i Përgjithshëm Programatik

Gjatë vitit 2020, Qendra Rinore H.A.N.A. ka përjetuar një transformim të jashtëzakonshëm dhe ka kaluar nga një hapësirë bosh në një strukturë të kompletuar me zona të ndryshme funksionale për të rinjtë. Përmes realizimit të objektivit tonë të parë, transformimi fizik i qendrës rezultoi në ngritjen e gjashtë këndeve funksionale: zona e multimedias dhe tregimtarisë, Punishtja e H.A.N.A. për artin e riciklimit dhe punës me dorë, zona e tryezës së rrumbullakët, zona e kafeterisë dhe këndit të argëtimit, mini-muzeu i dëshmorëve të demokracisë dhe zyra e qendrës. Ky transformim e ktheu H.A.N.A. në një ofrues shërbimesh unik në Qarkun e Lezhës, duke ofruar edukim jo-formal për të rinjtë e moshave 13-29 vjeç në kushte dinjitoze pune.


Për periudhën e parë të vitit (Janar - Prill 2020), në sfondin e pandemisë, qendra u përball me sfida të konsiderueshme në realizimin e aktiviteteve të para pas përfundimit të ambientit fizik. Marrja e vendimeve arkitekturore dhe procedurat e zgjatura të prokurimit ndikuan gjithashtu në vonesën e transformimit fizik, ndërsa situata me COVID-19 ndaloi grumbullimet e njëjzve dhe përshpejtimin e zbatimit. Megjithatë, në përputhje me vizionin e qendrës, në këtë periudhë u organizuan dy takime me drejtues të institucioneve arsimore për të prezantuar mundësitë e praktikave universitare dhe shërbimit komunitar të të rinjve.

Gjatë periudhës së dytë (Maj - Gusht 2020), qendra ishte e ngarkuar me aktivitete, duke përfshirë 24 aktivitete të ndryshme si video realizime, takime institucionale, aktivitete kulturore dhe sesione me të rinj. Ndërkohë që pjesëmarrja fizike e të rinjve nuk ishte në nivelin e parashikuar për shkak të pandemisë dhe kufizimeve të saj, prapë qendra arriti të krijojë mundësi të reja për pjesëmarrje dhe zhvillim personal të të rinjve në Lezhë. Aktivitete si shfaqje filmash, lojëra të brendshme e të jashtme, takime me folës motivacionalë, realizimi i klipesh të ndryshme, sesionet e storytelling dhe multimedias, dhe fushatat e pastrimit u kthyen në gur themeli për ndërkallimin e rinisë së Lezhës në jetën komunitare.

Rekrutimi i një të reje për të realizuar praktikën pranë qendrës H.A.N.A., i cili u realizua me sukses dhe u kthye në staf full-time, përfaqëson një arritje të konsiderueshme. Kjo tregon se qendra ka fituar një imazh të mirë si vend i mundësive për zhvillim profesional dhe edukativ për të rinjtë.

Periudha e fundit e vitit (Shtator - Dhjetor 2020) u karakterizua nga konsolidimi i programit dhe angazhimi në aktivitete të fokusuara në edukimin jo-formal dhe aktivizmin qytetar të rinisë. Kjo periudhë rezultoi me planifikimin dhe zbatimin e 39 aktiviteteve të ndryshme, ku veçanërisht vlen të përmendet zhvillimi i kursit të Storytelling dhe Multimedia me 18 të rinj që mësuuan nga 9 profesionistë, për të kuptuar dhe përdorur instrumentat mediatik për aktivizim qytetar.

Përveç kursit, për të trajtuar fenomenin e dhunës me bazë gjinore, u zhvilluan katër video dokumentarë, dy prej të cilëve ishin eksperimente sociale që treguan perspektivat e të rinjve dhe fëmijëve rreth dhunës



dhe pabarazisë gjinore. Gjithashtu, qendra zbatoi me sukses programin e klubeve rinore "Bëhu Burrë" me fokus edukimin mbi barazinë gjinore, ku 38 të rinj morën pjesë.

Këto aktivitete kanë qenë themelore në ndërtimin e bazave për zhvillimin e mëtejshëm të qendrës dhe kanë kthyer H.A.N.A. në një vend unik për edukimin, aktivizmin dhe argëtimin e të rinjve në Lezhë. Ndërkohë që jemi të vetëdijshëm për sfidat që na presin, sidomos në ruajtjen dhe pasurimin e këtij momentumit, ne mbetemi të përkushtuar që të ofrojmë një hapësirë të sigurt, edukative dhe inspiruese për të rinjtë e Lezhës. Në total, arritjet e vitit 2020 përfaqësojnë një progres të madh, duke hapur rrugë për projekte dhe bashkëpunime të reja për vitin 2021, si dhe duke i dhënë përparësi fuqizimit të rinisë dhe angazhimit të saj në jetën e komunitetit.

2. Projekte dhe aktivitete

Gjatë periudhës së vitit 2020, Qendra H.A.N.A. realizoi një seri të gjerë aktiviteteve të cilat kontribuan në zhvillimin e qendrës si një hapësirë e dedikuar për të rinjtë në Lezhë, si dhe për ndërtimin e shërbimeve dhe angazhimeve komunitare të reja për këtë grupmoshë. Përmes këtyre aktiviteteve, ne synuam jo vetëm forcimin e kapaciteteve të qendrës, por gjithashtu edhe krijimin e një klime mbështetëse për rininë e zonës, ku ata mund të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme edukative, artistike, dhe shoqërore. Aktivitetet e implementuara janë ndarë në disa periudha, duke u fokusuar në progresin e hështur, por të vazhdueshëm të qendrës.

Periudha Janar - Prill 2020


Gjatë fillimit të vitit 2020, aktiviteti kryesor i qendrës ishte pajisja dhe ngritja e zonave të reja funksionale. Ky proces u zhvillua për rreth njëmbëdhjetë javë, nga janari deri në prill, përkundër sfidave si periudha e izolimit midis 10 marsit dhe 15 prillit. Pavarësisht se ky aktivitet nuk përfshi pjesëmarrës direktë, ai përfaqëson një hap të rëndësishëm në krijimin e qendrës së re si një strukturë të mirëfilltë shërbimesh për të rinjtë në Lezhë.

Më 21 shkurt 2020, u mbajt një takim formal dypalësh në zyrat e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) në Lezhë, për të diskutuar për angazhimin e nxënësve të shkollave të mesme në aktivitetet e shërbimit komunitar pranë qendrës H.A.N.A. Takimi u zhvillua për një orë dhe përfshi përfaqësues ligjor të organizatës dhe përfaqësuesin e DRAP, z. Bardhok Pulaj.

Një takim tjetër u mbajt më 22 janar 2020 me kreun e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës, ku diskutuam për vendosjen e një marrëveshjeje për praktikat studentore të facilituara nga qendra jonë. Takimi u mbajt në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe zgjati për një orë, me pjesëmarrjen e tre personave.

Për tu përshtatur me situatën e izolimit, në prill 2020 qendra u angazhua në realizimin e një videoje frymëzuese që synonte të tregonte rutinën e një të riu gjatë karantinës. Ky aktivitet përfshi dy të rinj, por gjithçka u zhvillua virtualisht, pa asnjë shpenzim të lidhur.

Periudha Maj - Gusht 2020



Gjatë periudhës së dytë të vitit, aktivitetet e qendrës u rritën si në numër, ashtu edhe në larmi. Në maj, H.A.N.A. prodhoi një video edukative dhe informuese për COVID-19 dhe një video promovuese për heronjtë e rinj lokalë, Ola Bregu. Videot u shpërndanë në rrjete sociale dhe arritën një audiencë të konsiderueshme.

Në 26 maj 2020, në qendrën H.A.N.A. u nënshkrua një marrëveshje me Caritas Dioqezan Lezhë, duke krijuar bazat për bashkëpunime të ardhshme të frytshme. Më pas, në 28 maj, dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Tiranë vizitoi qendrën, me qëllim vendosjen e një partneriteti për studentët që dëshirojnë të zhvillojnë praktika profesionale.

Një prej aktiviteteve më të rëndësishme të kësaj periudhe ishte marshimi "Për Fëmijërinë e Vjedhur", mbajtur më 4 qershor 2020 në tregun industrial të Lezhës, duke mbledhur rreth 50 pjesëmarrës që u bashkuan spontanisht.

Në qershor 2020, qendra rinore u inaugurua zyrtarisht, dhe event i mbledhi 33 pjesëmarrës të cilët morën pjesë në këtë moment të shënuar për qendrën. Ndërkohë, fushata e pastrimit në lagunën Kune-Vain, më 26 qershor, mbledhi më shumë se 30 pjesëmarrës dhe tregoi përkushtimin e të rinjve ndaj mjedisit.

Muajt e verës u mbushën me aktivitete edukative dhe kulturore, duke përfshirë shfaqje filmash si "JoJo Rabbit" dhe "The Great Debaters", ashtu edhe fillimin e kursit të tregimtarisë dhe multimedias. Sesionet e para të kursit në Storytelling dhe Multimedia nisën me entuziazëm, duke mbledhur dhjetëra të rinj të cilët kërkuar të fitonin aftësi në këtë fushë.


Periudha Shtator - Dhjetor 2020

Periudha e fundit e vitit u karakterizua nga një intensifikim i angazhimeve dhe aktiviteteve, me synimin për të konsoliduar pozicionin e qendrës si një pikë referimi për të rinjtë në Lezhë. Kursi në Storytelling & Multimedia vijoi me sesione të shumta, për të cilat u mbajtën lista pjesëmarrësish, duke u mbyllur me sukses me klasën e parë në dhjetor 2020.

Përmes grupit të aktiviteteve "Bëhu Burrë", u trajtuan tema mbi barazinë gjinore, duke kontribuar në nxitjen e diskutimit për tema të ndjeshme dhe sfiduese për komunitetin e të rinjve në Lezhë. Aktivitetet si analizimi i dokumentarit "Neverland" dhe eksperimenti social "Vajzat Munden" theksuan nevojën për të sfiduar stereotipat gjinore dhe për të promovuar barazinë në shoqëri.

Gjithashtu, aktivitetet artistike u bënë pjesë e pandashme e programit, duke përfshirë prova për shfaqjen teatrale "Ri-edukimi i Apollonit" dhe realizimin e një shfaqjeje të plotë. Kjo përvojë u tregua tejet frytdhënëse për të rinjtë, duke i lejuar ata të shprehin kreativitetin e tyre dhe të trajtojnë tema të ndjeshme për komunitetin.

Përmbledhja e këtyre aktiviteteve të realizuara tregon përkushtimin e qendrës H.A.N.A. në krijimin e një hapësire dinamike dhe mbështetëse për rininë e Lezhës, duke kontribuar në zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Qendra vazhdon të promovojë përkushtimin ndaj edukimit jo-formal, barazisë gjinore dhe aktivizmit qytetar, duke nxitur të rinjtë të bëhen agentë ndryshimi për komunitetin e tyre.



Mësimet, Sfidat & Mundësitë

Gjatë periudhës së zbatimit të projektit në vitin 2020, Qendra H.A.N.A. ka hasur disa sfida të konsiderueshme, por ka hasur gjithashtu edhe mundësi për të rritur ndikimin dhe konsoliduar ofertën e saj si ofrues shërbimesh për të rinjtë në Lezhë.

Sfidat e Filluara me Hapjen e Qendrës dhe Pandemia COVID-19 Ngritja e një strukture të re në Lezhë ishte një sfidë që kërkonte angazhimin e plotë të themeluesve, të cilët duhet të linin mënjano angazhimet e mëparshme dhe të fillonin nga e para në një kontekst të vështirë. Në mungesë të një plani të detajuar projektimi për qendrën, ky u hartua nga e para, shpesh mes diskutimeve dhe mosmarrëveshjeve të shumta. Në fillimet tona, mungesa e një plani arkitekturor, limitimet buxhetore dhe kufizimet e ndërhyrjeve infrastrukturore krijuan vështirësi të konsiderueshme, duke na detyruar të ishim kreativë dhe të angazhoheshim vetë fizikisht në punimet e qendrës.

Një sfidë e madhe ishte gjithashtu dhe pritshmëria e lartë e komunitetit dhe institucioneve lokale. Duke qenë se Qendra H.A.N.A. ishte një ofertë e re për Lezhën, pritshmëritë ishin shumë të larta dhe kjo rriti barrën e përgjegjësisë për të kompletuar qendrën me të gjitha elementët e nevojshme, pavarësisht mungesës së solidaritetit nga disa institucione lokale që nuk na mbështetën me materialet e nevojshme.


Pandemia COVID-19 ndikoi negativisht, duke shpërndarë ciklin natyror të aktiviteteve dhe duke shkaktuar vonesa në finalizimin e punimeve dhe nisjen e aktiviteteve. Distancimi social dhe izolimi e ngadalësuan përparimin e qendrës dhe ndërprerja e kontakteve direkte me të rinjtë e institucione të ndryshme solli sfida të reja në vendosjen e bashkëpunimeve.

Eksperienca dhe Burimet Njerëzore Një kufizim i dukshëm ishte mungesa e eksperiencës së konsoliduar në ndërmarrjen e një iniciative të tillë nga e para. Pavarësisht përpjekjeve për të dhënë maksimumin, u ndje nevoja për këshilla profesionale, përfshirë dhe për aspekte ligjore, si dhe për sqarimin e disa pyetjeve të rëndësishme, si p.sh., nëse duhej një licensë specifike për kurset vokacionale apo nëse duhej të kishim module të akredituara për të ofruar shërbime të mërcantile.

Mënyra e rekrutimit të stafit gjithashtu ishte sfiduese. Nevoja për burime njerëzore që do të angazhoheshin në qendër në përmjet një dedikimi të plotë rezultoi e vështirë për të realizuar. Angazhimi i dy individëve si koordinator dhe financiar solli për një kohë shtesë forcë njerëzore, por mungesa e një shpërblimi të duhur ndikoi që ata të largoheshin në momentin kur iu ofrua diçka më e mirë.

Përmes përballjes me këto sfida, stafi i Qendrës ka fituar një zhdërvjelltësi të konsiderueshme, deri në atë pikë sa të jemi kërkuar si asistencë për organizata të tjera lokale për të tejkaluar sfida të ngjashme në themelimin dhe zbatim.

Norma e Ulët e Pjesëmarrjes dhe Balanca Gjimore Sfidat e arritjes së një pjesëmarrjeje të lartë të të rinjve dhe përmbushjes së objektivave në terma gjinorë ishte gjithashtu e pranishme. Vetëm 20% e pjesëmarrësve ishin djem, ndërsa pjesa më e madhe ishin vajza. Nevoja për tërheqjen e djemve drejt aktiviteteve të shoqërisë civile vazhdon të jetë një sfidë, e cila lidhet ngushtë me tendencat patriarkale dhe perceptimet tradicionale mbi rolet gjinore. Ndryshe nga qasja jonë e deritanishme, ku të rinjtë ftoheshin virtualisht përmes komunikimit, u pa që ishte e nevojshme që të kishte një qasje më aktive, si



përmes prezantimeve në shkolla, ashtu edhe duke bashkëpunuar me drejtuesit e tyre për zhvillimin e orëve të hapura.

Për të adresuar këtë problematikë, Qendra vendosi në bashkëpunim me shkollat e mesme lokale të zhvillojë orët e shërbimit komunitar, të cilat e bëjnë të detyrueshëm pjesëmarrjen për të dy gjinitë. Megjithatë, pandemia dhe kufizimet e saj ndaluan zhvillimin e plotë të këtyre nismave. Klubi "Bëhu Burrë" është gjithashtu një përpjekje për tërheqjen e djemve dhe vajzave drejt diskutimeve mbi barazinë gjinore dhe të ardhmen.

Kushtet Infrastrukturore dhe Ndikimet e Jashtme Gjatë periudhës së dimrit, mungesa e një sistemi ngrohjeje të përshtatshëm ishte një sfidë e veçantë, duke penguar zhvillimin e aktiviteteve në ambiente të brendshme në kushte të rehatshme. Edhe pse tentativat për të siguruar mbështetje nga Ambasada e Zvicrës për të plotësuar këtë nevojë ishin pozitive, deri në fund të vitit nuk patëm një rezultat konkret. Megjithatë, angazhimi miqësor i tyre mbetet një shpresë që këto nevoja të realizohen në të ardhmen.

Mundësitë dhe Sfidat me Programe të Reja Mundësia për ndërtimin e një kurrikule të re si shkollë dimërore mbi studimet politike dhe integrimin evropian ishte njëkohësisht sfidë dhe mundësi. Sfiduese, pasi na u desh të punonim në kushte të pasigurta, pa eksperiencë të mjaftueshme në këtë fushë. Nga ana tjetër, bashkëpunimi me një partner të kësaj natyre, siç është Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Luksemburgut, paraqet një shans të artë për afirmim dhe besueshmëri për qendrën tonë.


Përgjithësisht, përdorimi i rrjeteve sociale dhe angazhimi për të përditësuar ndjekësit ishte një përpjekje që, ndonëse sfiduese për nga volumi i punës, rezultoi si një mundësi fantastike për të rritur ndërgjegjësimin dhe prezencën e qendrës në komunitet.

3. Balanca Gjinore dhe Çështje tjera Ndërsektoriale

Që nga fillimi i nismës, Qendra H.A.N.A ka pasur një fokus të veçantë në ruajtjen e barazisë gjinore dhe përfshirjen e të rinjve nga të gjitha grupet komunitare. Kjo ka qenë e domosdoshme për të adresuar diskriminimin e fshehur ndaj vajzave dhe grave në role vendimmarrëse dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e djemve dhe burrave në aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuëse. Programi i ri-dizenjuar i Qendrës synon të thyejë tabutë e pjesëmarrjes në aktivitete të caktuara sipas gjinive, si dhe të nxisë përfshirjen e vajzave në aktivitete që tradicionalisht janë lidhur me figurën e djalit apo burrit dhe anasjelltas. Për shembull, vajzat inkurajohen të marrin pjesë në programet e punës dore dhe zejeve që përfshijnë mjete të zakonshme për djemtë, ndërsa djemtë ftohen të përfshihen në klubet e librit dhe aftësitë e qendisjes.

Një element tjetër i përfshirjes së barabartë është edhe ftesa për pjesëmarrje nga komuniteti Rom, i cili ka shifra të konsiderueshme në Lezhë. Kjo nismë vjen për të adresuar vulnerabilitetin që lidhet jo vetëm me përkatësinë etnike, por edhe me shkallën e lartë të braktisjes së shkollës dhe analfabetizmin në këtë grupmoshë.

Për momentin, pjesëmarrësit e qendrës janë në një masë të madhe të gjinisë femërore. Rekrutimi i vajzave ka rezultuar më i suksesshëm se ai i djemve, jo për arsye se kjo ishte politikë e qëllimshme e



Qendrës, por sepse vajzat janë përgjigjur më shumë thirrjeve për pjesëmarrje dhe kanë treguar më tepër iniciativë për të frekuentuar aktivitetet. Nga ana tjetër, interesi më i ulët i gjinisë mashkullore duket se lidhet me rrënjët patriarkale të familjes shqiptare, sidomos në veri, ku figura e djalit dhe burrit shihet si e përqendruar në aktivitete me rezultate të shpejta dhe të prirura nga fitimet, ndërsa angazhimet në shoqërinë civile konsiderohen si më pak të rëndësishme apo të "përshtatshme" për ta.

Sfida e ndryshimit të këtij mentaliteti ka qenë mjaft e vështirë, sidomos në kontekstin e situatës së pandemisë. Megjithatë, Qendra ka një plan rekrutimi në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave, i cili do të fillojë së zbatuari sapo nxënësit dhe studentët të rikthehen në shkolla dhe auditore. Ky plan synon të inkurajojë pjesëmarrjen e djemve dhe të ndreqë luhatjet gjinore në rekrutim dhe frekuentim.


Programi i Qendrës ka ruajtur gjithmonë një fokus të vazhdueshëm në ruajtjen e balancës gjinore, edhe pse barrierat e krijuara nga pandemia e COVID-19 kanë ndikuar në mbylljen e shkollave dhe kanë ndaluar disa nga nismat tona si për shembull orët e shërbimit komunitar (O.Sh.K). Megjithatë, Qendra ka përparuar në drejtimin e barazisë gjinore dhe përkushtimi i saj reflektohet në fushatën e 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore dhe në klubet "Bëhu Burrë." Këto fushata dhe klube kanë qenë përpjekje të këmbëngulura të Qendrës për të trajtuar me seriozitet tematikën e barazisë gjinore dhe të edukojë të rinjtë me mendësi të ndryshuar ndaj roleve gjinore.

4. Komunikimi, Shtrirja dhe Dukshmëria

Qendra H.A.N.A., që nga fillimi i projektit "Common Actions Contributing to Pro-Active Youth," ka synuar të rrisë vizibilitetin dhe të ndërgjegjësojë publikun për aktivitetet e saj në Lezhë. Megjithëse pjesa e parë e vitit iu dedikua ndërveprimit fizik për krijimin e qendrës dhe pajisjes së ambienteve, vizibiliteti i saj fillestar nuk ishte aq i lartë sa duhej, jo për arsye neglizhence, por për të ruajtur surprizën e inaugurimit dhe për të ndërtuar kuriozitetin e publikut. Ky ishte qëllimi kryesor pas postimeve sporadike në rrjetet sociale të qendrës, si Facebook dhe website zyrtar, të cilat u përdorën për të nxitur interesin dhe kureshtjen mbi aktivitetet e reja që po zhvilloheshin.

Facebook-u, si platforma më e përdorur në Shqipëri nga të rinjtë dhe publiku për çështje informimi mbi evente dhe aktivitete shoqërore, ka qenë mediumi kryesor për komunikim dhe promovim për H.A.N.A. Që nga fillimi i vitit 2020, ndjekësit tanë në Facebook janë pesëfishuar, duke arritur mbi 2000 ndjekës deri në prill. Kjo rritje e ndjeshme ka ardhur si rezultat i postimeve të vazhdueshme mbi progresin dhe aktivitetet e qendrës, të cilat kanë krijuar një ndërveprim të shtuar me publikun virtual. Ndërveprimi dhe mbështetja që kemi marrë nga ndjekësit tanë kanë reflektuar një interes të madh për qendrën, duke e kthyer atë në një pikë referimi për të rinjtë në Lezhë.

Përveç pranisë së rritur online, qendra ka siguruar që elementi i vizibilitetit të mbështetjes nga EED të jetë i dukshëm dhe në ambiente fizike. Kjo përfshin vendosjen e pllakës së donatorit në hyrje të qendrës dhe një baner të posaçëm që do të shoqërojë çdo aktivitet komunitar. Në vazhdim të vitit, vizibiliteti i H.A.N.A. dhe mbështetjes financiare nga EED do të rritet ndjeshëm, pasi programi i qendrës do të zgjerohet me aktivitete intensive për të rinjtë, për partnerët institucionalë dhe komunitetin në tërësi.



Për të rritur praninë dhe ndërveprimin me komunitetin, qendra ka publikuar edhe video dhe artikuj të ndryshëm, të cilët janë shpërndarë në rrjete sociale dhe platforma mediatike. Kjo përmban video si “Heronjtë Lokal” që sjellin në pah histori inspiruese të të rinjve dhe aktiviteteve që kryejnë në komunitet. Shumë prej tyre kanë arritur mijëra shikime dhe kanë ndihmuar në krijimin e një lidhjeje të drejtpërdrejtë me të rinjtë dhe komunitetin.

Përtej promovimit virtual, H.A.N.A. ka pasur një shtrirje të jashtëzakonshme në terren, me vizita nga organizata të ndryshme dhe bashkëpunime të suksesshme, të tilla si me Caritas dhe Sanità di Frontiera. Këto bashkëpunime janë një tregues i qartë i suksesit dhe impaktit të qendrës në komunitetin e Lezhës, duke sjellë një njohje më të gjerë për rolin e saj si promotore e aktivizmit rinor dhe e edukimit qytetar.

Platforma Facebook, Instagram, dhe hera-herës Twitter, kanë qënë mediumet kryesore për dukshmërinë dhe komunikimin e programit të qendrës, ndërsa përmirësimi i faqes zyrtare në internet do të jetë një fokus i vitit 2021. Aktivitetet e shumta të publikuara në rrjetet sociale, si dhe rekrutimet që janë kryer përmes kontakteve në internet, tregojnë që qendra ka krijuar një ndikim të konsiderueshëm në angazhimin dhe mbështetjen e të rinjve për programet dhe nismat e saj.

5. Vlerësime Përfundimtare


Duke përmbledhur përpjekjet e H.A.N.A. gjatë vitit të kaluar, mund të theksojmë se ky vit ishte një vit i zhvillimeve të rëndësishme dhe i përballjeve me sfida të shumta, duke sjellë si rezultat një progres të prekshëm në krijimin e një hapësire të dedikuar për rininë në Lezhë. Përmes bashkëpunimeve institucionale, përmirësimit të infrastrukturës, organizimit të aktiviteteve për zhvillimin e aftësive të reja, si dhe përpjekjeve për fuqizimin e të rinjve dhe rritjen e pjesëmarrjes së vajzave dhe djemve, qendra ka arritur të sjellë një ndikim të përceptuar pozitivisht nga komuniteti.

Qendra H.A.N.A. jo vetëm ka krijuar një hapësirë multifunktionale, por ka arritur gjithashtu të mbjellë themelet për aktivizmin rinor dhe për përfshirjen aktive në komunitet. Pavarësisht vështirësive të shkaktuara nga pandemia COVID-19, progresi është i dukshëm dhe ndërveprimi me të rinjtë ka qënë një shembull i përkushtimit tonë ndaj edukimit joformal dhe pjesëmarrjes së tyre aktive.

Rezultatet e arritura kanë treguar qartë se qendra H.A.N.A. nuk është thjesht një vendndodhje fizike, por një lëvizje e vërtetë për ndryshim në komunitetin e Lezhës. Aktivitetet e shumta të organizuara, nga sesionet e storytelling dhe multimedias, deri tek nismat për përf forcimin e barazisë gjinore dhe angazhimit social, kanë pasqyruar një vizion të qartë për fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve në tërësi.

Pavarësisht se sfidat e pjesëmarrjes së meshkujve dhe mungesës së burimeve në disa raste kanë qënë të ndërlikuara për t'u adresuar, veprimet strategjike dhe kreativiteti i stafit kanë ndihmuar në përballimin e këtyre pengesave. Duke u mbështetur në përvoja të fituara, qendra është në pozitë të mirë për të përmirësuar dhe konsoliduar më tej aktivitetet e saj për të ardhmen, duke synuar që të sigurojë një ambient gjithnjë e më të hapur, gjithëpërfshirës dhe inkurajues për të rinjtë e Lezhës.

Ky vit na ka mësuar se sfidat mund të shndërrohen në mundësi, dhe që energjia dhe përkushtimi i të rinjve, kur kanalizohet drejt zhvillimit personal dhe komunitar, mund të sjellë ndryshime të



qëndrueshme dhe të prekshme. Me fokusin tonë për të ardhmen, jemi të përkushtuar për të vijuar ndërmarrjen e hapave të guximshëm për të zgjeruar ndikimin dhe për të promovuar gjithnjë e më shumë kulturën e pjesëmarrjes dhe solidaritetit në komunitetin tonë.

6. Ndryshimi Madhor i Arritur

Një nga arritjet tona kryesore për vitin 2020 ishte krijimi dhe ngritja e qendrës rinore H.A.N.A. në Lezhë – qendra e parë dhe e vetme social-kulturore dhe multifunksionale për të rinjtë në këtë qytet. Ky projekt na mundësoi të krijojmë një hapësirë të sigurt dhe dinamike ku të rinjtë e moshave 13-29 vjeç mund të zhvillojnë aftësitë e tyre, të angazhohen në aktivitete sociale dhe kulturore, dhe të kontribuojnë aktivisht në komunitetin e tyre.

Me krijimin e hapësirës multifunksionale të qendrës, kemi arritur të përfundojmë transformimin fizik të një ambienti të zbrazët, duke e kthyer në një vend të pasur me aktivitete edukative, krijuese dhe argëtuese. Zona e multimedias dhe tregimtarisë, punishtja e artit të riciklimit, zona e kafeterisë, dhe mini-muzeu i dëshmorëve të demokracisë janë vetëm disa nga këndet funksionale që janë ngritur në kuadër të kësaj iniciative. Ky transformim i ka dhënë komunitetit tonë një vend unik që inkurajon edukimin jo-formal dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve.

Po ashtu, arritëm të zhvillojmë një numër të madh aktivitetsesh, duke përfshirë kurse të tregimtarisë dhe multimedias, klube rinore, aktivitete sociale e kulturore, trajnime mbi aftësitë për jetën, dhe fushata pastrimi. Angazhimi ynë për trajtimin e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe sensibilizimit mbi mjedisin u reflektua në projektet e zbatuara dhe në eventet e organizuara, ku të rinjtë patën mundësi të marrin pjesë dhe të kontribuojnë me mendimet e tyre.

Ndër sukseset kryesore ishte dhe fuqizimi i rolit të qendrës H.A.N.A. si aktor i rëndësishëm në komunitetin e Lezhës. Vizibiliteti i shtuar dhe njohja nga ana e institucioneve lokale dhe organizatave të tjera na ka vendosur në pozita të mira për të ndërthurur partneritete të reja dhe për të konsoliduar rolin tonë si një qendër mbështetëse dhe edukative për të rinjtë e rajonit.

Raporti i dorëzuar nga

(Emri i plotë, titulli, nënshkrimi dhe data)